

INA Consulting shpk  
NUIS: M32419008G

Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Abdyl Frasheri, Pallati Hekla, Shkalla 3, Tirane  
**KONTRATË DHURIMI**

Në Tiranë, sot më datë 19.12.2023 (dymijë e dymije e njezet e tre) palet kontraktuese vijuese

**DHURUESI:** Neshat Fana, shtetas shqiptar, lindur me 30.12.1960, ne Shumbat dhe banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal G01230021C, titullar i 33% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise INA Consulting shpk;

**NË FAVOR TË PËRFITUESIT:**

Ilirjan Hysi, shtetas shqiptar, lindur me 20.02.1962, ne Çorovode dhe banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal G20220113N, titullar i 33% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise INA Consulting shpk

dhe

Adriatik Baze, shtetas shqiptar, lindur e 13.05.1974, ne Çorovode dhe banues ne Durres, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal H40513065M, titullar i 34% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise INA Consulting shpk

**Baza ligjore :** Kodi Civil i Republikes se Shqiperise, Ligji nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, Ligji nr. Nr.9723, datë 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar.

Duke qene se

- Dhuruesi Neshat Fana është ortak i shoqërisë "INA Consulting" SHPK, zotërues i 33% të pjesemarrjes ne kapitalin themeltar te shoqerise.


- Dhuruesi, me anë të kësaj kontrate deshiron ti dhuroje secilit prej Perfituesve te dhurimit, ortakeve te tjere te shoqerise z. Ilirjan Hysi dhe z. Adriatik Baze, perkatesisht 17% dhe 16% te pjesemarrjes se zoteruar prej tij ne shoqeri.

- Në bazë të Vendimit dt 19.12.2023 të Asamblese se ortakeve të shoqërisë "INA Consulting" SHPK, është miratuar transferimi i 33% pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise ne zoterim të z. Neshat Fana, perkatesisht 17% te z. Ilirjan Hysi dhe 16% tek z. Adriatik Baze, me anë të një kontrate Dhurimi.

Atehere palet, ne perputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe me vullnetin e tyre te lire dhe te plote lidhin kontraten me kushte vijuese:

1. Objekt i kesaj kontrate eshte dhurimi i 33% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise INA Consulting shpk, me vlere 33.000,00 leke perkatesisht 2 ortakeve te tjera te shoqerise ne perqindjen 17% te z. Ilirjan Hysi dhe 16% tek z. Adriatik Baze.

2. Pala Dhuruese deklaron ne kete akt se pjesemarrja objekt dhurimi eshte e lire nga cdo barre, detyrim apo kusht tjeter te cdo lloji dhe natyre.



**INA Consulting shpk**  
**NUIS: M32419008G**

**Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Abdyl Frasheri, Pallati Hekla, Shkalla 3, Tirane**

3. Dhurimi behet pa kusht dhe pa shperblim.

4. Dhuruesi nën përgjegjësinë e tij deklaron se nuk ka asnjë pengesë ligjore nga ato të parashikuara në legjislacionin shqiptar për lidhjen e kësaj kontrate dhurimi.

5. Dhuruesi deklaron se, me nënshkrimin e kësaj kontrate, nuk do të ketë pretendime të natyrës financiare apo të ndonjë lloji tjetër ndaj pranuesit të dhurimit në lidhje me objektin e dhurimit, as tani dhe as në të ardhmen.

5. Përfituesit e dhurimit, z. Ilirjan Hysi dhe z. Adriatik Baze, janë dakord dhe pranojnë dhurimin përkatës të 17% dhe 16% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë së lartpërmendur. Me regjistrimin e kësaj kontrate në regjistrin tregtar përberja e ortakërisë së shoqërisë do të rezultojë si në vijim:

1. z. Ilirjan Hysi, titullarë e 1 kuote, të barabartë me 50% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë, të barabartë me 50.000,00 leke

2. z. Adriatik Baze, titullarë e 1 kuote, të barabartë me 50% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë, të barabartë me 50.000,00 leke


6. Duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate dhurimi Përfituesve të dhurimit i takojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë, të lidhura me pjesëmarrjen objekt kontrate.

7. Pala Pranuese e dhurimit do të depozitojë në Regjistrin tregtar këtë kontrate dhurimi të pjesëmarrjes dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e transferimit të pjesëmarrjes me anë të dhurimit në seksionin përkatës të ekstraktit të të dhenave të shoqërisë.

Kontrata u përpilua në tre kopje me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe. Kontrata nënshkruhet nga palët me vullnetin e tyre të lire, sot me datë 19.12.2023.


**Dhuruesi**

Neshat Fana



**Përfituesi**

Ilirjan Hysi



Adriatik Baze

